

ELEMENTET LEKSIKORE - SI PASURI SEMANTIKE DHE STILISTIKE NË VEPRËN E REXHEP QOSJES

Majlinda BUSHAJ

Abstrakt

Rexhep Qosja është një nga studiuesit më të shquar të letrave shqipe, që dallohet për vlerat dhe prurjet e shumta. Veprat e tij shquhen për gjuhën e jashtëzakonshme dhe prurjet e saj jo vetëm të natyrës fonetike e fjalëformuese, por edhe sintaksore dhe stilistike, një arritje kjo rrallë e shënuar në letrat shqipe. **Objekt i këtij studimi do të jetë pasuria leksikore dhe kuptimore e fjalësit të tij.** Qosja dallohet për dhuntinë e tij për të pasuruar gjuhën e tij me fjalë, nocione apo terma, si dhe togëfjalësha të rinj. Fjalësin e rrallë e kemi klasifikuar në fjalë të gjithëmbarshme të shqipes, fjalë gegë që mbajnë peshën e këtij punimi, fjalë me kuptime të reja që janë mundësi pasurimi për gjuhën shqipe, dialektizma, frazeologjizma etj. Me mjaft interes janë gegizmat e përdorur me funksion stilistik në gjithë veprën e tij. Në veprën e tij dallohet pasuria dhe larmia e leksikut, begatia e sinonimisë leksikore dhe sidomos e asaj sintaksore e stilistike, përorimi i tyre me efekte të mëdha shprehëse e me një origjinalitet të tejskajshëm.

Fjalët janë të gurrës popullore të trojeve verilindore, por edhe shumë fjalë të krijuara nga autori vitet e fundit, si: **shtatore, rrokaqiell, dëgjojse, shpuzore, tymtarë** etj.

Kur autori përshkruan personazhet përdor fjalë të trojeve verilindore si: **kulet, galuc, flokë krrela-krrela, latoj, kundruall, gulshohet** etj.

Me interes janë grupe fjalësh të prejardhura, të formuara me parashtesa e prapashtesa njëkohësisht: **përbirohem, përvldhem, kërleshem** etj.

Të shumta janë fjalët e përbëra të formuara nga vetë autori si: **trufasule, mendjetrokë, zemërbokë** etj.

Vepra e tij pavarësisht nga forma në të cilën është shkruar: kritikë, histori letërsie, ditar, biografi, prozë, dramaturgjia përfshin një sërë temash idesh a mesazhesh, që sillen rreth vlerave më sublimë të jetës njerëzore: lirisë, të drejtës dhe të vërtetës. Të njësishtme e bën veprën gjuha dhe stili i tij krejt i veçantë që dallohet nga qartësia e shprehjes dhe e mendimit, thellësia e gjykimit, sistemi i fortë i argumentimit, që arrihet përmes fjalës së bukur dhe të zgjedhur shqipe.

Fjalë kyçe: Leksik, fjalë e rrallë, gegizma, kuptime të reja, fjalëformim etj.

Rexhep Qosja është i njohur ndër ne kryesisht si kritik letrar e si historian i letërsisë shqipe, si autor studimesh e veprash monografike përgjithësuese madhore në disa fusha të dijes.

Ai është njëherazi shkrimtar e dramaturg me merita mjeshtër i ligjërimit letrar, një nga njohësit dhe studiuesit më në zë të letërsisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe si mjet i realizimit të veprave letrare artistike.¹ Në veprën e tij vërejmë zbatimin e normës letrare, gërshtuar me ngjyresën e nevojshme krahinore të krejt ligjërimit në përgjithësi e të disa personazheve në veçanti, pasurinë dhe larminë e madhe të leksikut, begatinë e sinonimisë leksikore dhe sidomos asaj sintaksore dhe stilistike, përdorimi i tyre me efekte të mëdha shprehëse e me një origjinalitet të madh, gërshtimi e harmonizimi i fjalëve të zakonshme, të leksikut të gurrës popullore, herë- herë edhe krahinore të ngushta të anëve verilindore, me ato të zgjedhura, me termat e fjalëformimet librore apo me leksikun e stileve funksionale të gjuhës së shkruar që i përket mbarë shqipes. Objekt i këtij studimi do të jetë pasuria leksikore në veprën e Rexhep Qosjes.

Në veprën e tij jam ndalur kryesisht në pasurinë leksikore të këtij autori duke vënë në dukje fjalët e gegërishtes verilindore, fjalët gjuhëpastruese, frazeologjizmat, krijimet e autorit etj.

¹ Gjovalin Shkurtaj, *Shënime për gjuhën e romanit "Vdekja më vjen prej syve të tillë"* të Rexhep Qosjes, botuar në Peshë e fjalës shqipe, Tiranë 2009, f. 211.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p2915>

Fjalë të trojeve verilindore në veprën e rexhep qosjes

- **Bakëzi** “bakeq, njeri që bën keq”. Xhezairi, tani, ishte **bakëzi**, ogurzi, që ia sheh sherrin; ai ishte mendjekeqi, që i shkon mendja gjithkund e përgjithçka; ai ishte dyshimtari, që dyshon edhe në të zotin; ai ishte sufruesi, që të nxit të fusësh dorën në prush; ai ishte ndjellakeqi, që të thërret kobin. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 64).
- **Cokrroj** “përplaseshin, ndesheshin, tokeshin”. Dhe kishin filluar të **cokrroheshin** gotat dhe kishin filluar të **puqeshin** buzët dhe kishte filluar të jehonte kënga. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 37).
- **Curulat** “lëkund”. Mbas saj ishte një karrige me rrotë, e veshur me lëkurë të zezë në të cilën, duke u curulatur sulltani edhe bënte punët edhe pushonte. (Nata, f.151).
- **Gaca** “shkëndija”. Sytë i qesin **gaca**. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 80).
- **Galiç** ndaj. “i mbledhur në gjunjë”. Kishte qenë **galiç**, prandaj kishte rënë përmbys. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 25).
- **Galuç/galuc** ndaj. “sinonim me galiç”. Gjatë gjithë kësaj kohe, kur havaja e saj ishte e stisur prej reve të zeza, që premtinin breshër, Trashja shihej duke ndenjmur natën **galuç** në stelë he duke lëvizur buzët sikur i falej zotit, ose mallkonte njerëzit. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 22). Jo, - përgjigjet shkurt dhe ulet **galuc** në karrige, ulet rëndë-rëndë, si t’i kishte Bjeshkët e Thata në supe.(Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 123).
- **Kalamendem** “me u lëkundë sa në një anë në një tjetër; me u marrë mendsh; me u trullosë” ...si bualli që ia kanë hequr zgjedhën vetëm kur është rrëzuar në baltën e trashë, **kalamendem** rrugës... (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 104).
- **Kalavesh** “vil, grec”. Kam ngrënë drekë: bukë e lakra dhe, në fund, një **kalavesh** rrushi; pjesën tjetër e hëngrën gruaja me fëmijët. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 90).
- **Kërlesh** “ngatërroj”. U janë **kërleshur** zylyfët e gjatë. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 215).
- **Kundruall** “përballë”. Ulet memece **kundruall** meje, e përmbledh dhomën me sy, e largon skajin e palltos vetëm sa t’i shihen kupat e gjunjve dhe, mandej, zëulët më drejtohet: (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 112).
- **Lakadredhas**. Dhe unë u frikësosem jashtëzakonisht lartësive çfarë janë ato në të cilat ishte ngjitur Faruku, për shkak se jam i bindur prapsht se, për t’u ngjitur ashtu lart, duhet ecur shumë **lakadredhas** dhe nëpër do shkallë të veçanta, e unë as nuk di të eci lakadredhas, as të ruaj peshën nëpër shkallët e veçanta. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 42).
- **Lanet** “djall”. Ti qenke **lanet**, -i them dhe ia vë dorën kupës së kresë që të mos çahet. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 79).
- **Lukth** “gjoks”. Më dhemb kryet doktor, më dhemb këtu, në **lukth**, doktor; më ther mes shpatullash doktor, mbrëmë shtatë herë janë çuar të derdh ujë doktor. (Një dashuri dhe shtatë faje, Tiranë, 2003, f.297).
- **Marramendas** “i papërqëndruar”. Pastaj ishte çuar kishte nisur të sillej **marramendas** rreth thesit sit ë ishin mallkimi he urimi i saj në të dhe, në fund, na i kishte gozhduar sytë e saj, tani s’e di, të përgjakur apo të përletur! (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 21).
- **Maza** “cipa, lëkura e qepës”. Lahej me sapun teshash kur i zbutej zemra dikujt t’ia falte, por më shpesh me hi të qarrit, që ia tëhollonte lëkurën si maza e qepës. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 16).

- **Mrrolem** “mblihem, tulitem”. Gratë, të cilave u kishte shkëlqyer fytyra kur kishin dëgjuar fjalën e parë, **ishin mrrolur** kur kishin kapur krejt fjalinë, që s’ ishte mjaft e qartë, pse nuk mund ta dinin se çfarë lidheje kishin tani ato fjalë dhe pse dyshonin mos i zoti i shtëpisë i kishte ftuar t’i përgjonte në atë mënyrë. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 35).
- **Ngucen** “zihen”. Por e di se pasanikët e mëdhenj nuk duhet të **ngucen**: ata e kanë edhe mbrojtjen e madhe, them. (Nata është dita jonë, f. 112).
- **Përbiroj**. Teksa dola nëpër atë derë të madhe, të gjerë e të gjatë, si dyert që u ka vënë kështjellave Drakula, të forcuar me do hekura të trashë, aq të trashë e të përdredhur në formën e burgjive, sanuk kanë mundur **t’i përbirojnë** as predhat e topave italianë, po, kushedi, do të mund t’i tejshkonin predhat e katjushave ruse....(Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 104,136). Me gozhda të ngulura në sy **përbirohem** prej kalimtarëve. (Një dashuri dhe shtatë faje, Tiranë, 2003, f.300).
- **Përdheket**. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 108).
- **Përqyrran** “qurravesh, qurran”. Trashen e Dervish Mukailit e mbaj mend nga fëmijëria, kur të mëdhenjtë akoma më quanin çilimi, të papjekur, **përqyrran**, ndonëse isha aq i madh, sa shpeshherë mund t’i jepja vetes të drejtën të kisha mendimin tim për disa çështje, për të cilat thoshin se kalamajtë si unë nuk mund të gjukojnë si duhet. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 14).
- **Përqyrret** “qurravitet”. Disa palë sy kthehen kureshtarë nga tryeza artistike; vetëm një djalosh, tri tryeza më tutje, i qan hallin vajzës që **përqyrret**: ndoshta s’kanë me çka që përqyrret: noshta s’kanë me çka ta çlirojnë zguarin e saj prej së papriturës.(Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 111).
- **Përrockë** “rrjedhë uji e vogël”. Në atë kohë të lashtë përmes Vajzanit kalonte një lumë i vogël, gati **përrockë**, të cilit vajzanazit i thoshin Lumi i Mullenjave, sigurisht, për arsye se në verishtën, që ia kishte pushtuar brigjet, kishte shumë mëllenja, të cilat ata i mbanin për të shenjta. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 5).
- **Përvjedh** “shikoj në fshehtësi”. Papritmas pushon së qeshuri, bëhet serioz si prifti kur zgjidh tlinat para gruas së huaj, **përvjedh** me sy grupin e kalimtarëve, që llup-llup e rrahin plluskavinën përtej nesh, trotuarit tjetër. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 107).
- **Prishaqef** “me qef të prishur”. **Prishaqef** Njerëzit e territ shtërngohen të pajtohen me arsyet që ua vë përpara pse edhe unë prishaqef do të detyrohem të heq dorë prej qëllimit për t’i bërë titull të romanit. (Nata është dita jonë, f. 105).
- **Prishaqejfas** ndajfolje. **Prishaqejfas** njerëzit ishin pajtuar. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 11).
- **Rrapitoll** “rrëzoj përdhe”. Është thatësi e madhe, si kurrë s’mbahet mend, toka po çahet prej zhegut, arat e livadhet po digjen, gjëja e gjallë po **cofin** prej etjes, do të bëhemi shkrumb, do të bëhemi **rrapitoll** me tokë. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 9).
- **Shita** “figurë mitologjike që u bënte keq njerëzve”. Coka ngrin në vend, sit a kishte shituar **shita**, e shikon si t’i kishin sjellë pesë metra qefin, sorollatet poshtë e lart dhomës, si t’i ishin lidhur zorrët, fryn e shfryn, si t’i ishte zënë fyti, dikur përmallohet...(Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 55).
- **Shkoqem** “ndahem”. Dhe, teksa zemërplasur shkoqem prej Heronjve të ditëve tona më vardiset Kentauri. (Nata është dita jonë, f. 104).
- **Shkurrajë** “vend me shkurre”. Metalia e Batushës e kishte zënë Trashën në bregun e lumit, në **shkurrajë**, ku ajo lahej rehat-rehat një të marte të nxehtë. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 17).

- **Shuk** “bistak”. *Dhe, unë i kisha thënë, sado as sot nuk e kam të qartë pse isha turrur aq shpejt që t’i them se në një fotografi që ende ruhet në shtëpinë e xhaxhait tim të vjetër, Kudusiut, në Vajzan, gjyshja ime symadhe, shihet se si vajzë i lëshonte flokët rrip pas shpinës, që atje i thonë **bistak** e në një tjetër se si i mblidhte top majë të kokës, që atje i thonë **shuk**, kurse përfundi të dyjave ishte shkruar emri dhe mbiemri i saj: Zoje Kurti! (Nata është dita jonë, f. 27).*
- **Skopan** “c’jap i tredhur”. *Le të bëhet **skopan**, në dashtë edhe le t’i kthejë me këmbë përpjetë, në dashtë, të gjitha këto karrige e tryeza. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 112).*
- **Të kalamendur** mb. “të trullosur” *E kaloj Sheshin e Madh duke dëgjuar jehonën e pridhur të fjalëve të Talit **të kalamendur** dhe hyj në Rrugën e Kovaçëve: një qen asht e lëkurë kërkon ushqim në hedhurinat, që janë bërë kodër e madhe. (Një dashuri dhe shtatë faje, Tiranë, 2003, f.298).*
- **të kërleshur** “të ngatërruar”. *Unë thotë duke më mbuluar me kokën e tij **të kërleshur**, jam titulli më i qëlluar dhe më i kuptimshëm për romanin që po shkruan. (Nata është dita jonë, f. 104).*
- **Tëhollonte** “hollonte shumë”. *Lahej me sapun teshash kur i zbutej zemra dikujt t’ia falte, por më shpesh me hi të qarrit, që ia tëhollonte lëkurën si maza e qepës. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 16).*
- **Tlina** “veshje popullore, branavekë”. *Papritmas pushon së qeshuri, bëhet serioz si prifti kur zgjidh **tlinat** para gruas së huaj, përvjedh me sy grupin e kalimtarëve, që llup-llup e rrahin plluskavinën përtej nesh, trotuarit tjetër. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 107). (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 107).*
- **Torolangej** “rrokullisej”. *E kisha parë Trashën se si **torolangej** drejt fushës ashtu si nuk e kisha parë kurrë dhe kisha qëndruar në vend me bindjen se ajo do të vazhdonte në atë drejtimin e saj të zakonshtëm, që të zhdukej për disa ditë. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 23).*
- **Trumëhazur** “i trembur nga një veprim i shpejtë i dikujt tjetër dhe nga kjo me humbë drejtpeshimin e mendjes e të veprimeve të tij; me u habitë e mos me ditë nga me shkue”. *I befasuar, i hutuar, i shqetësuar dhe i **trumëhazur** njëkohësisht, e shikoj dhomën shpejt e shpejt në të katër anët e, mandej, përqëndrohem me ngadalë që ta studioj hollë e mirë, si të isha gjetur për herë të parë në të, ndërsa zemrën e ndiej kur e shpejton ritmin e çrregulluar. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 72).*
- **Turravrap** “me shpejtësi”. *Thoshte se çdo njeri është i dhënë pas diçkaje dhe shtonte **turravrap**, se sa më e rëndësishme, më e madhe të jetë ajo “diçka”, aq më e çmuar është jeta e njeriut. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 29).*
- **Verri** “kullotë në mal”. *Bujqit e bujkeshat, dhentë, lopët, dhitë, kuajt, gomarët, qentë, macet, pulat e patat, rosat e bibat, sakicat e kmesat, kazmat e lopatat, tëfurqit dhe grabujat, bulirat dhe kënaçet i kishte lënë në fshatra, në fusha e në male, në verri e në bjeshkë...(Nata, f.151.)*
- **Vurratë** “shenjë, gjurmë”. *Për këto arsye Trashja gati gjithmonë apo vurratë tjetër të keqe, të freskët në trup: herëfarë mëshikëze në ballë, herë farë vregne në këmbë, herë njërën buzë të enjtur e herë njërin sy të mavijosur. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 19).*
- **Rrethojë** “gardh”. *Kur kisha arritur jashtë qytetit, kisha parë një **rrethojë** telash, prej së cilës dilnin xixa të zjarrta që ngriheshin drejt qiellit dhe sa më lart ngriheshin, aq më të mëdha dukeshin. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 92).*

Fjalë gjuhëpastruese në veprën e qosjes

Përpjekja për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe që ka shënuar gjithë fuqinë e saj në periudhën e Rilindjes Kombëtare, mund të thuhet se ka vazhduesit e saj përgjatë gjithë shekullit '20 e në vazhdim. Nëse për rilindasit kujdesi për gjuhën kishte kuptimin në rend të parë të shpëtimit të gjuhës nga rreziku që kanosej realisht nga elementet e huaja dhe duhet të shihet si kërkesë objective-historike për autorin *“kjo përpjekje nuk është vetëm dashuri e kujdes për pasurinë vetjake, por përpjekje shumë e ndërgjegjshme për zhvillimin e mëtejshëm të shqipes, përpjekje për zbulimin e gjallërimit e pasurisë së saj e të mjeteve të saj”*.² Ashtu si krijuesit e mëdhenj edhe Rexhep Qosja krahas synimeve të veta mirëfilli letrare, ka edhe mëtimet gjuhësore, të cilat shfaqen jo vetëm në punën gjuhëpastruese e gjuhëpasuruese, por edhe në përzgjedhjen apo parapëlqimin ndaj kategorive të ndryshme të fjalëve apo mjeteve fjalëformuese. Këto fjalë janë së pari fjalë shqipe, të marra nga goja e popullit, ose të krijuara prej tij për të mënjeluar fjalë të huaja të panevojshme, sidomos turqizma dhe fjalë të tjera nga gjuhët evropiane. Në veprën e Qosjes ndeshim një sasi të konsiderueshme fjalësh, të cilat ai i përdor për të mënjeluar fjalët e huaja përkatëse si të tilla mund të renditim disa prej tyre si: **tymtar** në vend të **oxhak**; **ngrohtore** në vend të **kaldajë**, **mishtore** në vend të **kasaphane**; **foshnjore** në vend të **çerdhe**; **hirtore** në vend të **tabaka duhani**; **ngadhënjimtar** “entuziast” etj.

- **Dëgjojëse** “receptor”. *Lëshoje dëgjojësen, qe ku jam!* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 78).
- **Flokëtar** “parukier/i”...si silleshin ndaj dhomandreqesve, ndaj kamariereve, ndaj flokëtarëve kur i ndreqnin flokët apo kur rruheshin; në ç’gjendje i linin dhomat kur shkonin. (Nata është dita jonë, f. 21).
- **Foshnjore** “çerdhe”...nxënës me çanta në shpinë duke shkuar në shkolla dhe fëmijë të mbajtur përdore duke u çuar në **foshnjore**; (Nata është dita jonë, f. 16).
- **Gjimbajtëse**. *I con flokët disa gishtërinj më lart*- një pjesë e tyre në njërën anë të ballit hark; e sjell qaforen me zemër në fund rreth qafës me dorën e majtë, kurse me dorën e djathtë e ndreq gjimbajtësen! (Nata f. 169).
- **Gojëtare** “oratore”. *Gojëtare e dalluar*. (Bijtë e askujt, f. 146).
- **Gushore** “gjerdan”. U kanë rënë facoletat, u janë prishur bishtalecët u janë shprishur flokët e krehur; nëpër tokë i kanë lënë fustanet e gjata, dimitë e rënda, hallhallet, vathët, **gushoret** e arta dhe gurët e çmuar. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 216).
- **Hirtore** “tabaka duhani”. *E afroj hirtoren: është përplot duqa cingaresh!* (Nata është dita jonë, f. 17).
- **Lëshojkë** “grua e ndarë”. Ky është viktimë e fundit e **lëshojkës** së njohur të Zeqan Hoxhës. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 116).
- **Majtak** “që punon vetëm me dorën e majtë, sallak”. *Nuk iu shkon mendja se jam majtak!* (Nata është dita jonë, f. 41).
- **Mishtore** “vend ku shitet mishi, kasaphane” ...meshkuj dhe gra duke pritur para shtëpive shëndetsore, neuroklinikës, para furrave, para **mishtoreve**, para shtëpive të mallrave që tani quhen vetshëbime; (Nata është dita jonë, f. 16).
- **Ngadhënjimtar** “entuziast”. *Buzëqeshur e kishte ledhatuar dhomën me shikim ashtu siç e ledhaton njeriu me sy vetëm atë që e bën të lumtur dhe menjëherë kishte veshur këmbishën e bardhë e pantallonat bojë qielli dhe, duke lëmuar flokët e thinjur, po të shpeshta, kishte dalë në tarracën e shtëpisë së tij të posandërtuar dhe i kishte lëshuar*

² Shefkije Islamaj: *Kur fjala shqipe bëhet përkushtim jetësor* (Mbi gjuhën e veprave shkencore të prof. Idriz Ajetit dhe të prof. Rexhep Qosjes), botuar në *Gjuha Shqipe*, 29, nr. 1/ 2011.

një shikim ngadhënjimtar qytetit. (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 27).

- **Ngrohtore** “kaldajë, bolierë”. *Sa të kthyer nga Perëndimi, sa nga Lindja, sa nga Veriu, si nga Jugu; si shtetet e vogla: herë sillen vetë e herë sillen prej shteteve më të mëdha; tymtarin e ngrohtores së qytetit, i cili deri në vjeshtën e vonë kishte marrë pushim veror; sahatkullën e mbytur prej blozës, të ngritur në kohën e sulltanit të fundit...* (Nata është dita jonë, f. 15).
- **Njëmendësia** “vericiteti”. *Romani bashkëkohor është mrekullia letrare e kohës sonë: në të bashkohen poezia, filozofia dhe shkenca; njëmendësia dhe fikcioni; e vërteta dhe misteri.* (Nata është dita jonë, f. 105).
- **Plleshme (e)** “fertile”. *Dhe më mirë e kam të mendoj për Rudinën, që është e plleshme si toka humusore e Kosovës, por a mund të mendoj vetëm për të kur e shoh aq shpesh Danjollin pas shpine dhe më del aq shpesh përpara sysh Arifi i çmendur?* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 51).
- **Plleshmëri** “fertilitet”. *Dhe mos iu frikëso plleshmërisë, se ne do të përtërihemi përmes shpenzimeve tona, që do t’i amshojmë me bukurinë e mendimit dhe të ndjenjës.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 51).
- **Rrokaqiell** “grataçiel”. *I kishte pëlqyer shumë, pa masë, ajo pikë vrojtimi, që i krijonte përshtypjen, aq të rrallë e aq të çmuar, se gjendej në katin më të lartë të rrokaqiellit më të lartë të Vajazanit.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 27).
- **Shitore** “dyqan”. *Te shitorja e madhe e librave, kur ndaloj rrallë, pres të ma ngjesë për dore ajo çupëlina e pafajshme, me sy të humbur dhe zë të dridhur, si atëherë kur u nda prej Hënës dhe, si vetëtimja, të më thotë: -Xhezair pse ke dalë në këtë kohë?* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 90, 128).
- **Shpuzore** “tavëll duhani, taketuke”. *Tashti nuk ndien nevojë të as të ulesh pranë tryezës që s’ t’i zë mirë këmbët përfundi, që me lapsat, fletët, fletoret, skedat, ngjitëset, kutitë e shprazëta të cingareve, shpuzoret, stilografët, kapëset, të qitura vend e pavend, dhe me makinën “Erika”, të kthyer anash, dëshmon se një shqetësim është realizuar në harmoninë e imagjinatës duke lënë realitetin e saj në gjendje çrregullsie.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 130).
- **Shtatore** “buste”. *Si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë i ka shtatorete edhe në disa fshatra.* (Bijtë e askujt, f. 142).
- **Trimëroj** “inkurajoj”. *Duke u kollitur, e trimërojnë njëri-tjetrin, bërtasin me të madhe e unë dëgjoj vetëm fjalën: Iblisi, Iblisi, Iblisi.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 215).
- **Trus** “ushtroj presion”. *Kur ia trusin hashimin mes këmbëve të lagura sigurisht nuk nxiton si këtu në rrugë.* (Nata është dita jonë, f. 31).
- **Tymtar** “oxhak”. *Qyteti ishte shtrirë në luginë, i larëm, i gjatë dhe i gjerë, i megjulluar prej tymtarëve djathtas e i pastër si xhami majtas dhe merrte frymë me një ritëm të rregullt si ndonjë polib i qetësuar në fund të detit.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 27).
- **Ushtrimore** “palestër”. *...dhe të kishit ushtruar në ushtrimoret në të cilat kishte ushtruar Ajo:* (Nata është dita jonë, f. 77).

Shprehje popullore

Në prozën tonë janë të shumtë shkrimtarët, që i japin rëndësi të madhe përpunimit të gjuhës dhe shfrytëzimit sa më të gjerë të mjeteve të saj ata kanë futur në përdorim fjalë, shprehje e konstrukte të panjohura më parë për gjuhën letrare. Edhe Rexhep Qosja e ngjesh deri në përsosmëri fjalën, frazeologjinë dhe sintaksën e shqipes, i cili përpiqet për t’i gjetur çdo fjale a

thënieje kuptimin e ngjyresën më të përshtatshme a më të efektshme. Në veprat e autorit gjen vargje fjalësh të bukura, pak të përdorura, të cilat si për nga kuptimi ashtu edhe për nga funksionet artistike janë të denja, jo vetëm për kontekstet ku janë përdorur, por për t'u përdorur gjerësisht edhe në gjuhën e letërsisë artistike e jashtë saj. Prej gurrës popullore ai thith gjithnjë në mënyrë krijuese dhe sjell numër të madh fjalësh, frazelogjizma e togfjalështa të qëndrueshëm që mbartin frymën popullore e ngjyresat më të bukura popullore, por që treten e shkrihen natyrshëm me trajtat normative letrare duke e bërë veprën e tij letrare të fuqishme dhe me peshë të madhe ndikuese te lexuesi. Po japim disa shembuj nga kjo dukuri:

- **Si thupra në ujë.** *Sa ora i ishin zhdukur rrudhat e fytyrës, kurse buzët kishin filluar t'i dridheshin si thupra në ujë.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 24).
- **Ua kishte prurë shpirtin në hundë.** *Ky Muja paskësh thënë se Danjollin duhej ta lidhnin këmbë e duar për shkak se i zgjidhur ua kishte prurë shpirtin në hundë komshinjtë me marifetet e tij.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 44).
- **Nuk e vlen barra qiranë.** *Të gjitha të tjerat janë të dorës së dytë: nuk e vlen barra qiranë të mbyllet njeriu në rrjetën e vetmisë me vjet dhe të merret me cikërrima:* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 70).
- **Sa çel e mbyll sytë.** *Sa çel e mbyll sytë i palos skaj Belbanit.* (Nata është dita jonë, f. 42).
- **M'u kanë lidhur dardhë në fyt.** *M'u kanë lidhur dardhë në fyt lëvdatat.* (Nata është dita jonë, f. 44).
- **Kodër pas bregut.** *Nuk dëshiroj të dëgjoj biseda të tilla kodër pas bregut, ua pret fjalën më i vjetri.* (Nata është dita jonë, f. 69).
- **Si pulë e lagur.** *Binaku mërdhin, më zgjat dorën që i dridhet dhe, duke lënë përgjysmë ditën e mirë, ikën si pulë e lagur.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 107).
- **Si peshku në lëndinë.** *Shikoj i lumtur si peshku në lëndinë:* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 115).
- **Fill e për pe.** *Cilësia ime që të mendoj për të tjerët e, sidomos për fqinjët, që i shoh aq shpesh, ka një histori të gjatë dhe të hershme, që në këtë mes, meqë nuk është vendi, s'mund t'jua rrëfej fill e për pe.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 39).
- **I hedh dritë në sy.** *Pse anëtarët e saj do të na hedhin dritë në sy edhe pse punët do t'i bëjnë në terr.* (Nata është dita jonë, f. 105).
- **Kërkojnë qime në vezë.** *Dhe, si zakonisht, anëtarët e Jurisë sonë, të cilët, sit ë gjitha juritë tona, digjen për të drejtën, të vërtetën dhe të bukurën, kanë arsye të kërkojnë qime në vezë, prandaj edhe mund të thonë: titulli Nata është dita jonë e përgjithëson të keqen për shoqërinë tonë!* (Nata është dita jonë, f. 106).
- **Me kokrra e dokrra.** *Janë intelektualët tanë më të shquar e më të dashur, të njohur për nisma me rëndësi atdhetare edhe përpara, them, dhe vazhdoj me qëllim që të mos e lë të na bezdisë me kokrra e dokrra.* (Nata është dita jonë, f. 119).
- **E çel gojën.** *Kur s'ia çel gojën ecja e Ajshes së Zeqanit, s' besoj se mund t'ia çelë tjetërkush.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 221).

Krijime të çastit

Me forcë të madhe artistike janë përdorur në vepër edhe krijime të çastit të shumtën e herës Shkurta mendon se janë mbi gjedhet popullore, por duke shkuar shumë larg tyre si:

- *Kur zgjohej në mëngjes prej zhurmës, sharjeve, qarjeve, lamtumirave, mirupafsheve, hyrje-daljeve, shkoardhjeve ardhjeeshkuarjeve, thashethemeve, nëveshpëshpëritjeve, nëbesëthënjeve, jabëfshajakthefshave dhe kompozitave të tjera origjinale ose të*

huajtura e mallkonte fatin e vet të shtjerrë, si shoshë, pse e kishte dënuar t'i dëgjonte të gjitha ato... (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 31).

- *Ka treguar ai edhe herë të tjera se kush është: një snob, mendjemadh, mikroborgjez, filistin, hipokrit, injorant, llafazan, njeri **shtjeremerr**, **nxitepërfito**, **kapemosqit**, **dorëdjathtëxhepmajtë**, **shikomajtasecdjathtas**, **brekëkuqbythëgjjerë**, **gojëmbëlbesëqen**.* (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 189).

NDJFOLJE ME PRAPASHTESËN –SHËM

*Këto vitet e fundit, ka një prirje të theksuar të shkruasve drejt ndajfoljeve me prapashtesën –shëm, si: këndshëm, gëzueshëm, hareshëm. Këtë prirje e ndeshim edhe te Qosja. Dëshmi e qartë është fakti se aty gjejmë aq shumë ndajfolje të formuar me këtë prapashtesë. Vetëm në një nga romanet e tij dalin një sasi shume e madhe ndajfoljesh të tilla. Pajtohem **plotësisht**, (Nata:105), *Garipi dhe Demi*, **bashkërisht**, *ua vënë gishtërinjtë tregues*(Nata:111), *shprehur **teprueshëm*** (Nata:116), *shpjegoj **bindshëm*** (Nata:119), *kishte hyrë në dhomë **tinëzisht*** (Nata:121), *shikon **adhurueshëm*** (Nata:121) etj.*

Fjalët e përbëra

Në gjuhën shkencore të prof. Rexhep Qosjes vërehet një përpjekje tepër parimore për zëvendësimin e fjalëve të huaja të panevojshme me fjalë ekzistuese të shqipes ose krijimi i numrit shumë të madh të neologjizmave të përshtatshëm. Në këtë kontekst dhe në këtë veprimtari gjuhësor larghedhëse siç do të thoshte Qosja ai është ruajtës, po sidomos është krijues shumë dorëmbarë. (Islamaj, Gjuha shqipe 2011).

- *Më së shumti më kishte pëlqyer kur njëherë, në Malme, një suedeze **flokëverdhe**, **vetullhark**, **syqiellore**, **lëkurëhollë**, si mëndafshi, në çastin kur e kisha përmbledhur mirë, më kishte thënë: më ke gozhdur për shtrati si të ishe kurd.* (Nata është dita jonë, f. 27).
- *Prej gojës **buzëvrenjtur**, **buzëmavijosur**, **dhëmbëthyer**, rrjedhin vrushkuj të vrullshëm të gjakut të vluar në zjarrin e ndezur nga grushtet e mi.* (Nata është dita jonë, f. 63).

Një fytyrë mjaft të veçantë ka ligjërimi i tij, përse i përket sintaksës poetike, ku ai tashmë dallohet qartë për disa mënyra ndërtimi të tijat, siç janë përsëritjet me karakter intensive të mbiemrave dhe të pjesoreve apo ndajfoljeve, apo lidhëzave etj.

- *Sa të dua Liri. **Si sytë e ballit. Si loçkën e zemrës. Si dritën e diellit.*** (Nata është dita jonë, f. 46).
- *Ti e ndien veten të shprazët, fyell, bosh, **si shtogu kur ia nxjerrin palcën, si peshku kur ia shtryllin vezët, si lehona kur ia heqin foshnjën.*** (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Tiranë, 1986, f. 130).

Thënie popullore

- *Kurrë nuk i është përmbajtur fjalës popullore: **atij që zgjohet herët i takojnë dy nafaka.*** (Nata është dita jonë, f. 114).
- ***Guri që lëviz prej vendit të vet nuk ndalet më kurrë, në asnjë vend!*** (Bijtë e askujt 2, f.9).
- ***Ujku e ndërron qimen, por nuk e ndërron hujin, ia kthej.*** (Nata, f.166).

Proza e Qosjes ashtu ashtu si edhe e mjaft shkrimtarëve të tjerë kosovarë, Ramiz Kelmendit, Anton Pashkut, Mehmet Krajës, Jusuf Gëvallis etj. mbështetet gjerësisht në traditën e pasurisë gojore të prozës popullore, duke thithur së andejmi sidomos mprehtësinë e thënies, të folurit me nëntekste të fuqishme, frazeologjizmat apo fjalët e urta për t'i ngjizur me tiparet më të mira të prozës artistike. Në tërë veprën e tij spikat njohja e mirë që ka autori për normën letrare, të cilën e zotëron me zotësi e aftësi të lëndueshme, por edhe zotërimi i fjalës së bukur shqipe, i figurshmërisë popullore e artistike të kultivuar, të trashëguar nga tradita e letërsisë. Prej këtyre gurrave ai thith një numër të madh fjalësh, frazeologjizmesh e togfjalëshash të qëndrueshëm që mbartin frymën popullore e ngjyresat më të bukura krahinore, por që treten e shkrihen natyrshëm me trajtat normative letrare, duke e bërë ligjërimin e veprës së tij të pasur, të mprehtë, të fuqishëm me peshë të madhe te lexuesi.

Gjuha e romaneve të Rexhep Qosjes është gjuha e romaneve me kufij të zgjeruar. Shefkije Islamaj është shprehur: *Gjuha e romaneve të Rexhep Qosjes është gjuha standarde në kuptimin jo vetëm të përfshirjes, por edhe të krijimit të risimeve të nevojshme për shprehjen e tij gjuhësore. Këto risime në rend të parë i hetojmë në rrafshin strukturor dhe në rrafshin leksiko-frazeologjiko-sintaksor.*³

Të njësishtme e bën veprën gjuha dhe stili i tij krejt i veçantë që dallohet nga qartësia e shprehjes dhe e mendimit, thellësia e gjykimit, sistemi i fortë i argumentimit, që arrihet përmes fjalës së bukur dhe të zgjedhur shqipe. Rexhep Qosja është një nga njohësit më të mirë të shqipes së sotme letrare. Me veprën e tij shkencore, letrare, publicistike e politike ka dhënë një ndihmesë të çmuar për lëvrimin e pasurimin e gjuhës sonë të përbashkët letrare. Gjuha e tij vazhdon të luajë rol të drejtpërdrejt në lëvrimin e stilit të ri shkencor e publicistik, të ligjërimin libror në përgjithësi.

Referencat

- [1]. A. Xhuvani, *Pastërtia e gjuhës*, Vepra I, Tiranë 1980.
- [2]. Ag Apolloni, *Metafora e madhe*, botuar në Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.46/2016, f. 71-90.
- [3]. Agim Vinca, *Rexhep Qosja ose korifeu i kritikës shqipe*, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 26, 1996, f. 25-32.
- [4]. *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, Tiranë, 1971-2005.
- [5]. Emin Kabashi, *Vepra letrare e Rexhep Qosjes*, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 26, 1996, f. 41-45.
- [6]. Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, Gjuha jonë 1/1981, f. 36-47.
- [7]. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.
- [8]. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 2002.
- [9]. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.
- [10]. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- [11]. Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2009.
- [12]. Jani THOMAI, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981.
- [13]. Jani THOMAI, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010.
- [14]. Jani THOMAI, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
- [15]. Jorgo Bullo, *Figurë poliedrike e botës së sotme shqiptare-shkruar me rastin e 60-vjetorit të lindjes së Rexhep Qosjes*, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 26, 1996, f. 49-54.
- [16]. Jorgo Bullo, *Rexhep Qosja-Korife i shkencës*, botuar në Gjurmime albanologjike: seria e shkencave filologjike. - Nr. 41/42, 2012, f. 294-298.
- [17]. Jorgo Bullo-Korife i shkencës, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 41, 42/2012, f. 293-297.
- [18]. Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2009, rib. 2014.
- [19]. Qemal Murati, *Rexhep Qosja -krijues dhe pasurues i shqipes intelektuale*, Gjuha shqipe 1, 2006, f. 36-41.

³ Sh. Islamaj, *Romani Bijtë e askujt dhe gjuha standarde*, botuar në: gaz. Ballkan Ëeb, 04.04. 2016

- [20]. Shefkije Islamaj, *Një jetë kushtuar kombit* (Rexhep Qosja), Gjuha shqipe, 24, nr. 3, 2006, nr.3. f. 109-113.
- [21]. Shefkije Islamaj, *Tipat e ligjërimit në Ditarin e Rexhep Qosjes*, botuar në Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.46/2016, f. 41-69.
- [22]. Shefkije Islamaj: *Një jetë kushtuar kombit* (Rexhep Qosja), Gjuha shqipe, 24, nr. 3, 2006, nr.3. f. 109-113.
- [23]. Rexhep Qosja, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Tiranë, 1986.
- [24]. Rexhep Qosja, *Nata është dita jonë*, VEPRX XV, Prishtinë, 2010.
- [25]. Rexhep Qosja, *Një dashuri dhe shtatë faje*, Tiranë, 2003.
- [26]. Rexhep Qosja, *Bijtë e askujt*, VEPRX XVII, Prishtinë, 2010.